

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve dhe administratës së drejtësisë bllokohen, Shoqatat kërkojnë zbatimin e menjëher shëm të vendimit të Gjykatës Kushtetuese – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pagat-e-magjistrateve-dhe-administrates-se-drejtetise-blokohe-n-shoqatat-kerkojne-zbatimin-e-menjeher-shem-te-vendimit-te-gjykates-kushtetuese/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:52:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 14:21:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ddeb3c02843023fa0deb57817c0cae08a2ab8f6fe8f2bdb1bf676db7f9ceed97
TEKSTI	cec87c8f27adb099cb3cced8ef2b055cd3b4ce8bd5be3556db0804cfae8f012b
PAMJA	38d965fb3f93aa6743bb1eb942081d8b6be2cbd895524259ee2dc420f79da603

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	353a1c7aefe3576a78071171be5d3dc976bfc655ec06547f6a1805f83facacc4
E MËPARSHMJA	454f097d3d84775cddc314d47ba97e74d373ec54503d89d71efa9edb5bcf6995
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/353a1c7aefe3576a78071171be5d3dc976bfc655ec06547f6a1805f83facacc4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Unioni i Gjyqtarëve, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve dhe Shoqata e Prokurorëve kanë reaguar ashpër ndaj bllokimit të pagave të magjistratëve nga Thesari i Shtetit, duke e cilësuar situatën të papranueshme dhe duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme nga Ministria e Financave.

Sipas shoqatave, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndryshimit të formulës së pagave, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë ndërmarrë hapat administrativë për zbatimin e saj. Pagat e magjistratëve janë përlogaritur sipas formulës së re dhe listëpagesat janë dërguar për ekzekutim.

Megjithatë, sipas deklaratës së përbashkët, Thesari i Shtetit nuk po i ekzekuton pagesat për pjesën më të madhe të sistemit të drejtësisë.

Shoqatat e magjistratëve e konsiderojnë të papranueshme që një vendim përfundimtar dhe detyrues i Gjykatës Kushtetuese të mbetet pa efekt praktik për shkak të pengesave në fazën e ekzekutimit financiar.

Sipas tyre, situata nuk përbën thjesht një problem teknik apo procedural të administrimit të buxhetit, por prek drejtpërdrejt funksionimin normal të sistemit të drejtësisë dhe sigurinë financiare të magjistratëve.

Reagim i Unionit të Gjyqtarëve dhe Shoqatës Kombëtare të

5 "Dhembja e pjekurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emëlli juaj

Abonohu

Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Prokurorëve

Unioni i Gjyqtarëve, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve dhe Shoqata e Prokurorëve, në vijim të qëndrimeve të përbashkëta lidhur me zbatimin e vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese, shprehin shqetësimin e thellë për situatën e paprecedentë të krijuar aktualisht, ku sipas të dhënave, pagat e magjistratëve, funksionarëve të organeve të sistemit të drejtësisë, si dhe të personelit të administratës gjyqësore dhe asaj të prokurorisë nuk po ekzekutohen.

Siç është njoftuar më parë, pas mbarimit të afatit të caktuar nga Gjykata Kushtetuese, nga data 01.08.2026, përlllogaritja e pagave të magjistratëve duhet të kryhet mbi bazën e formulës së përcaktuar nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Kjo formulë zbatohet me efekt prapaveprues edhe për periudhën 01.04.2023–31.07.2026.

Në zbatim të këtij detyrimi, institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kanë ndërmarrë veprimet përkatëse administrative. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 435, datë 26.08.2026, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 144, datë 28.08.2026, kanë miratuar pagën referuese bazë të magjistratit, sipas arsytimit të vendimeve nr. 15/2026 dhe nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, duke përcaktuar zbatimin e saj për periudhën nga data 01.08.2026 e në vazhdim.

Njëkohësisht, njësitë përgjegjëse për buxhetin janë ngarkuar të fillojnë pagesën e pagave sipas përcaktimit të ri. Megjithatë, sot, më datë 02.09.2026, në mënyrë të paprecedentë, ky proces është penguar në fazën e ekzekutimit financiar.

Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Thesarit, pagat e magjistratëve, ndonëse janë përlllogaritur dhe urdhëruar për pagesë në zbatim të vendimmarrjeve përkatëse, nuk po ekzekutohen. Pasojat e kësaj situatë nuk kufizohen vetëm te magjistratët, por shtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në funksionimin financiar dhe administrativ të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Përfundimisht, nga të dhënat e administruara, rezulton se vetëm në zyrat e dy prokurorisë në vend janë ekzekutuar pagat e magjistratëve, sipas listëpagesave të dërguara me përlllogaritjen e re si më lart, ndërkohë që për pjesën tjetër të sistemit të drejtësisë nuk është bërë ekzekutimi i tyre. Shoqatat e magjistratëve e konsiderojnë të papranueshme që një vendim i Gjykatës Kushtetuese, përfundimtar, i detyrueshëm dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm, si dhe për zbatimin e të cilit institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, të mbetet pa efekt praktik dhe që magjistratët dhe funksionarët e tjerë të sistemit të drejtësisë të mbeten pa paga për shkak të pengesave të krijuara në hallkën e ekzekutimit financiar.

Çdo vonesë apo pengim në ekzekutimin e pagesave të miratuara dhe të urdhëruara sipas formulës së përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk përbën thjesht një çështje teknike apo procedurale të administrimit buxhetor. Në këtë rast, bëhet fjalë për një situatë që prek drejtpërdrejt funksionimin normal të sistemit të drejtësisë, sigurinë financiare të magjistratëve dhe efektivitetin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Për rrjedhojë, ajo prek respektimin e themeleve të rendit kushtetues dhe të parimit të shtetit të së drejtës, si dhe prodhon pasojë të drejtnëdrejta

pasiguri financiare dhe institucionale. Vonesat në ekzekutimin e detyrimeve sjellin pasiguri financiare dhe mund të krijojnë detyrime financiare shtesë për institucionet publike për shkak të diferencave të papaguara dhe pasojave që mund të rrjedhin prej tyre.

Një situatë e tillë krijon një precedent tejet shqetësues për mënyrën e respektimit dhe zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në një shtet të së drejtës. Për më tepër, është veçanërisht domethënës fakti që pagat e magistratëve janë ekzekutuar në dy prej zyrave të sistemit të drejtësisë, ndërkohë që për pjesën tjetër, pagesat vijnë të jenë të bllokuara. Ky fakt konfirmon se zbatimi financiar i vendimmarrjeve për pagat është i mundur dhe se mosekzekutimi i tyre në pjesën tjetër të sistemit është i pajustificueshëm.

Një situatë e tillë e bën situatën edhe më të papranueshme dhe ngre një shqetësim serioz për ligjshmërinë e mosekzekutimit të pagesave në njësitë ku ato nuk janë kryer. Për këto arsye, i bëjmë thirrje të menjëhershme strukturave përgjegjëse administrative të Drejtorisë së Thesarit që të përmbushin detyrimet e tyre dhe të mos pengojnë ekzekutimin e pagesave të urdhëruara nga institucionet e sistemit të drejtësisë, në zbatim të vendimit nr. 15, datë 17.02.2026, të Gjykatës Kushtetuese. Njëkohësisht, i bëjmë thirrje Ministrisë së Financave që të marrë masat e nevojshme për të garantuar ekzekutimin e menjëhershëm të pagave të magistratëve dhe funksionarëve të sistemit të drejtësisë, si dhe që ky proces të mos shndërrohet në një burim të mëtejshëm dëmi financiar për sistemin e drejtësisë dhe institucionet publike.

Në mënyrë të veçantë, i kërkojmë Ministrit të Financave që, në ushtrim të përgjegjësisë të tij institucionale, të marrë masa të menjëhershme për të garantuar që strukturat administrative në varësi të tij të veprojnë në përputhje me efektet detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të mos pengojnë zbatimin e tyre për shkak të procedurave të administrimit apo ekzekutimit buxhetor.

Situata e krijuar nuk prek vetëm magistratët. Pengimi i ekzekutimit të listëpagesave dhe i veprimeve financiare të institucioneve të drejtësisë po sjell pasojë të drejtpërdrejta edhe për administratën gjyqësore dhe administratën e prokurorisë, duke bërë që edhe punonjësit e këtyre administratave të mbeten pa marrë pagat e tyre në afatet përkatëse, ndonëse nuk janë subjekte të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese për pagat e magistratëve.

Bllokimi i pagave të punonjësve të administratës gjyqësore dhe të prokurorisë cenon drejtpërdrejt funksionimin normal të institucioneve të drejtësisë. Për këtë arsye, kërkohet ndërhyrja e menjëhershme e Ministrit të Financave për garantimin e vijimësisë së pagesave, zhbllokimin e situatës së krijuar dhe marrjen e masave të nevojshme që raste të tilla të mos përsëriten.

Unioni i Gjiqtarëve, Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve dhe Shoqata e Prokurorëve do të vijojnë ta ndjekin nga afër situatën, duke konsideruar çdo vonesë të mëtejshme në ekzekutimin e pagave si një situatë absolutisht të papranueshme për funksionimin normal të sistemit të drejtësisë dhe si cenim të zbatimit të vendimit detyrues të Gjykatës Kushtetuese. Në mungesë të një zgjidhjeje të menjëhershme, shoqatat do të përdorin të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkimin e përgjegjësisë ligjore të personave dhe strukturave përgjegjëse për pengimin ose mosekzekutimin e pagesave.

#ShoqataKombëtareeGjyqtarëve

#UnioniiGjyqtarëve

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

KRONIKË

Breshëria e plumbave në Mat, kush ishte...

Xhuljana Zhuleku Dje 14:17

KRONIKË

Mesazh me plumba ndaj një gruaje?!...

Xhuljana Zhuleku Dje 12:19

KRONIKË

Shpërthimi me tritol në Shkodër, policia j...

Taulant Halili Dje 00:27



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale